


Statistikat tregtare te Kosovës

Tregtia e jashtme e mallrave eksporti-importi, 2021 deri nëntor 2024

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe të dhënat Open_DATA nga Doganat e Kosovës(DK) për periudhën janar nëntor 2024 tregojnë një rritje të deficitit tregtar prej 6.5% në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2023, gjegjësisht në vlerë prej -4,868.1 milion Euro krahasuar me deficitin -4,572.0 milion Euro sa ishte deri nëntor në vitin 2023. Eksporti mbulon importin me 14.6%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave sipas viteve në mil. Euro



(*) deri nëntor 2024


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Eksporti i mallrave për periudhën **janar nëntor 2024** arrin vlerën 832.2 milion Euro, që është një rritje prej 5.8% krahasuar me 786.8 milion Euro, periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Partneret kryesor për eksportin e mallrave janë vendet e CEFTA me 388.7 milion Euro apo 46.7%(Shqipëria me 18.5%, Maqedonia e Veriut me 16.0%, Serbia me 5.8%, Mali i Zi 4.9% etj., si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm) dhe vendet e BE_27 me 262.0 milion Euro apo 31.5%(Gjermania me 10.7%, Italia me 4.0%, Austria me 2.3%, Franca me 2.1% etj., si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm), nga vendet tjera Zvicra me 36.8 milion apo 9.2%, SHBA me 36.6 milion apo 4.4%, Turqia me 25.1 milion 3.0% dhe Tjera me 43.3 milion apo 5.2% si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm.

Sipas të dhënave të grupeve kryesor të eksportit e përbëjnë: 24.5% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11.8% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 11.2% Artikuj të ndryshëm të prodhuar; 11.2% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 9.3% Produktet minerale, etj si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm.

Figura 2. Eksportet e mallrave sipas vendeve në %



(*) deri nëntor 2024


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Importi i mallrave për periudhën **janar nëntor 2024**, sipas të dhënave Open_DATA nga Doganat e Kosovës arrin vlerën 5.700.3 milion Euro, që është një rritje prej 8.6% krahasuar me 5.248.2 milion Euro, periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Partneret kryesor të importit të mallrave janë vendet e BE_27 me 2.556.0 milion Euro apo 44.8% (Gjermania me 14.1%, Italia me 5.2%, Greqia me 5.1%, Polonia me 3.3%, Bullgaria e Kroacia me nga 2.1% etj., si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm), dhe vendet e CEFTA me 748.8 milion Euro apo 13.2% (Shqipëria me 5.3%, Maqedonia e Veriut me 4.5%, Serbia me 1.9% etj., si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm), nga vendet tjera prin Turqia me 828.7 milion apo 14.5%, Kina me 688.4 apo 12.1%, SHBA me 83.4 milion apo 1.5%, Zvicra me 34.8 milion 0.6 % dhe Tjera me 760.3 milion apo 13.3% si pjesëmarrjen në importin e përgjithshëm.

Sipas të dhënave të grupeve kryesor për import e përbëjnë: 13.8%; Produktet minerale; 12.2% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 12.2% Makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 11.6% Mjetet e transportit; 10.1% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 7.6% Produkte të industrisë kimike etj. si pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm.

Figura 3. Importet e mallrave sipas vendeve në %



(*) deri nëntor 2024

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Burimi:

Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK), *Tregtia e jashtme - Treguesit tremujorë:*

https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_External%20trade_Monthly%20indicators/06_exp_country.px/

Doganat e Kosovës (DK), *Open_DATA_Import_Export Janar-Nëntor 2024:*

https://dogana.rks-gov.net/SharedFolder/DocumentFiles/Open_DATA_Import%20Janar-N%C3%ABntor%202024.xlsx